



Pranimi / Przetvora Prijem / Prijava Accept / Delivery	06 - 05	2022	2	viti god year
Organizata / Organizacija Org. št. / Org. št.	SKIMS/SHK	2665/2022		
Udhëheqës / Udhëheqësja Org. / Org. št.				
Shtesa / Prilog Priloz / Priloz				
Sasia / Kolicina Quantity				115



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.317/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.317/2022 të datës 31.03.2022 të parashtruar nga ankuesja kundër masës disiplinore "Vërejtje" të datës 16.03.2022 të shqiptuar nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejt, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 06.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.317/2022 e datës 31.03.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet masa disiplinore "Vërejtje" e datës 16.03.2022 e shqiptuar ndaj ankueses nga mbikëqyrësja e saj e drejtpërdrejt.
- III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë që të largoj nga dosja personale e nëpunësit civil dhe regjistri përkatës masën disiplinore sipas pikës 2 të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, më datë 31.03.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër masës disiplinore "Vërejtje" e shqiptuar përmes emailit më datë 16.03.2022 nga udhëheqësja e drejtpërdrejtë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.04.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Ministrinë e Shëndetësisë. Ndërsa Këshilli më datë 14.04.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1765/2022 të datës 31.03.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Emailit të datës 31.03.2022; Urdhër Obligim për Pagesë me Nr.29571; Shkresë nga Sistemi FreeBalance me mbishkrimin Obligim i datës 09.03.2022; Kërkesë për mallra dhe shërbime nga Ministria e Shëndetësisë datë 22.02.2022; Libër dorëzimi me mbishkrimin dorëzoi datë 10.03.2022; Emaili i datës 11.03.2022 lidhur me orarin e QOE-së; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 10.02.2022; Vërejtjen e datës 16.03.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.04.2022; Përgjigjen në ankesë e datës me 14.04.2022; Akt Emërimit e datës 10.03.2012; Emailin e datës 31.03.2022 për regjistrimin e vërejtje në regjistrin e vërejtjeve; Emailin e datës 13.04.2022; Emailin e datës 09.12.2020 nga për lejimin e pagesës së obligimeve; Emailin e datës 09.12.2020, 10.12.2020 nga Emailin e datës 09.12.2020 nga Emailin e datës 17.03.2022 nga për ankuesen; Emailin e datës 17.03.2022 nga ankuesja; Emailin e datës 17.12.2020 nga për ankuesen; Emailin e datës 17.12.2020 nga Emailin e datës 17.12.2020 nga Emailin e datës 17.12.2020 nga Emailin e datës 17.12.2020 nga Emailin e datës 15.12.2020 nga Emailin e datës 14.12.2020 nga Emailin e datës 18.12.2020 nga për ankuesen; Emailin e datës 18.12.2020 nga ankuesja për Emailin e datës 18.12.2020 nga Emailin e datës 17.12.2020 nga Emailin e datës 17.12.2020 nga Emailin e datës 09.12.20219 nga për ankuesen; Shkresa per gjendjen aktuale hyrje/dalje prej datës 01.04.2022 deri 13.04.2022; Emailin e datës 02.03.2020 nga për ankuesen; Emailin e datës 02.03.2020 nga Emailin e datës 21.02.2020 nga ankuesja; Emailin e datës 21.02.2020 nga Emailin e datës 02.04.2020 nga për ankuesen; Emailin e datës 02.04.2020 nga ankuesja për Shkresë për anulimin e zotimit e datës 01.04.2020; Urdhër Obligim për Pagesë Nr. 37319, Nr.40639; Emailin e datës 01.04.2020 nga Emailin e datës 26.03.2020 nga për ankuesen; Emailin e datës 25.03.2020 nga ankuesja për Emailin e datës 24.03.2020 nga Emailin e datës 24.03.2020 dhe 16.03.2020 nga Emailin e datës 16.03.2020 nga Kërkesë për mallra dhe shërbime; Emailin e datës 07.05.2020 dhe 05.05.2020 nga për ankuesen; Emailin e datës 06.05.2020 nga ankuesja; Emailin e datës 04.12.2020, 22.12.2020 nga K.Berisha për ankuesen; Dëshmi nga FreeBalance i Thesarit të Kosovës; Emailin e datës 19.02.2021, 07.04.2021, 08.04.2021, 03.06.2021 nga për ankuesen; Emailin e datës 03.06.2021 nga Emailin e datës 03.08.2021 nga Emailin e datës 29.07.2021 nga Emailin e datës 19.11.2021 nga për ankuesen; Emailin e datës 15.02.2022, 16.02.2022, 09.03.2022 nga për ankuesen.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës konstaton se është e bazuar ankesa e ankueses **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës 12.12.2013, është e punësuar në pozitën *Zyrtare Financiare* në Ministrinë e Shëndetësisë.

Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë më datë 16.03.2022 përmes emailit zyrtar ka shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore "Vërejtje", me arsyetim: *"dje rreth orës 15:45 keni sjellur lenden për pagese të tatimeve të unë e cila nuk ka mundur të paguhet, te njëjtën ju keni deklaruar që keni pranuar të lënë në mëngjes nga zyrtarja e shpenzimeve. E nderuar, duke ditur që data 15 është afati i fundit i pagesave ju vetëm 15 minuta me heret keni sjellur lenden gje e cila nuk ka mundur të paguhet. Si pasojë e kësaj për shkak të këtij veprimi Ministria e Shëndetësisë do të paguaj ndëshkime për mos pagese me kohë të tatimeve dhe kjo mbetet nën përgjegjësin tuaj. E nderuar, pas vërejtjeve të një pas njëshme që janë duke u bërë ndaj jush ju ende vazhdoni të bëni neglizhenca në punë andaj kërkojë nga ju që të rritet përgjegjësia e punë dhe të jeni e përgjegjshme bazuar në kontratën që keni lidhur me Ministrinë e Shëndetësisë"*.

Ankuesja në ankesën e parashtruar brenda afatit ligjor në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë me rastin e shqiptimit të masës disiplinore nuk ka marrë parasysh faktin se me datë 15.03.2022 kam qenë e angazhuar në Qendrën Operative Emergjente të MSH prej orës 08-20 dhe për këtë ka qenë e njoftuar vet Udhëheqësja dhe se mos ekzekutimi i lëndës është bërë si rezultat i mos respektimit të planit të shpenzimeve sepse lëndën në fjalë e kam dorëzuar më datë 10.03.2022 tek Zyrtarja e Shpenzimeve, përmes librit zyrtar të nënshkruar sepse të njëjtën ditë e kam pranuar nga asistentja e administrative e ZKF-së. Me tej shton se është fakt se zotimin e kam bërë më datë 09.03.2022 dhe këtë e vërteton kërkesa për mallra dhe shërbime ndërsa kjo lëndë është aprovuar më datë 22.02.2022 nga Zyrtari i autorizuar ndërsa më datë 23.02.2022 nga Zyrtari Kryesor Financiar; Nuk qëndron fakti që kam vërejtje të njëpasnjëshme sepse performancën time në punë e vërteton vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021. Andaj, mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë me rastin e shqiptimit të masës disiplinore nuk është mbështetur në asnjë dispozitë ligjore, po ashtu nuk ka arritur të konstatojë se çfarë shkelje disiplinore kam bërë e që sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka pasur për obligim të bëjë.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht kapitullin IV lidhur me Disiplinën në Shërbim Civil, si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, me të cilën është rregulluar në mënyrë specifike procedura dhe masat disiplinore për nëpunësit civilë, ndërsa në aspekt të përgjegjësisë disiplinore, Kolegji ju referua nenit 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku theksohet se: *Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i dulur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit.* Ndërlidhur me këtë e në kuptim të nenit 46 paragrafi 4 të të njëjtit ligj si shkelje të lehta disiplinore janë kualifikuar: *4.1 mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.*

Nga vlerësimi i provave të lëndës Kolegji ka gjetur se masa disiplinore "vërejtje" është shqiptuar ndaj ankueses lidhur me mos pagesën e kontributeve të tatimeve për stafin e punësuar për luftimin e pandemisë COVID-19 në vlerën 58.064.53 Euro, brenda afatit siç pretendohet deri më datë 15.03.2022. Kolegji sipas dëshmive nga freebalance, ka gjetur se zotimi i mjeteve në shumë e lartcekur është bërë më datë 09.03.2022, ku paraprakisht kjo shumë ka qenë e aprovuar nga Zyrtari Autorizues dhe Zyrtari Kryesor Financiar me datë 22.02.2022, fakt ky që dëshmohet edhe përmes Urdhër Obligimit për Pagesë me Nr. 206220235 ose Nr.29571. Po ashtu Kolegji në bazë të

librit të dorëzimit pranimit të shkresave të dorëzuar nga ankuesja konstaton se Urdhër Obligimin me Nr. 206220235 ose Nr. 29571, ankuesja e ka dorëzuar më datë 10.03.2022, po në të njëjtën datë lënda është pranuar nga Zyrtarja e Shpenzimeve, me ç'rast akti i dorëzimit dhe pranimi është bërë me nënshkrim nga zyrtaret përgjegjës, e si rrjedhojë pretendimi i ankueses se lëndën e ka përcjell me kohë tek Zyrtarja e Shpenzimeve është i bazuar.

Përkitazi me pretendimin e mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë i thekuar në shkresën për shqiptimin e masës disiplinore, se ankuesja më datë 15.03.2022 në orën 15:45 ka sjell lëndën, Kolegji sipas emalit të Burimeve Njerëzor të datës 11.03.2022 ka konstatuar se ankuesja me datë 15.03.2022 ka qenë e angazhuar në Qendrën Operative Emergjente të MSH prej orës 08-20, dhe së Udhëheqësja e saj ka qenë njoftuar me këtë plan, andaj, nisur nga ky fakt rrjedhë së është i pabazuar pretendimi në fjalë.

Përkitazi me pretendimin ankimore të ankueses së ankuesja nuk ka pas vërejtje të njëpasnjëshme sepse performancën time në punë e vërteton vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021, Kolegji duke ju referuar provave të lëndë ka gjetur së mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë ka vlerësuar ankuesen për vitin 2021 me notën 3.5 "shumë mirë" dhe po ashtu e njëjta kundrejt ankueses ka dhënë sqarime dhe vërejtje përkitazi me përmbushjen e detyrave të punës, mirëpo nuk ka dëshmi së ndaj ankueses është shqiptuar ndonjë masë disiplinore "vërejtje" ashtu siç është përcaktuar me nenin 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1 lidhur me nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me ligjshmërinë e masës disiplinore të kundërshtuar me ankesë, e në kuptim të dispozitave të nenit 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-116 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil*, vlerësoi se Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankueses me rastin e shqiptimit të masës disiplinore nuk ka bërë cilësimin juridik të shkeljes/ve të kryera nga ankuesja dhe po ashtu e njëjta nuk ka pas parasysh elementet e përgjegjësisë disiplinore siç parashihet me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku theksohet se: *Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"* rrjedhimisht Kolegji nga provat materiale ndërlidhur me veprimet apo mosveprimet e ankuesit përkitazi me mos pagesën e kontributeve të tatimeve për stafin e punësuar për luftimin e pandemisë COVID-19, në vlerën 58.064.53 Euro, nuk ka gjetur elemente të përgjegjësisë disiplinore për shkelje të lehtë disiplinore sepse ankuesja nuk ka neglizhuar përmbushjen e detyrave të punës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ka përgjegjësi kryesore që të menaxhoj dhe kontrolloj vartësit të tij në realizimin me kohë të detyrave të punës, dhe sipas gjykimit të Kolegjit respektimi i planit buxhetor të shpenzimeve bie nën përgjegjësinë e Zyrtarit Kryesor Administrativ dhe Zyrtarit Kryesor Financiar ashtu siç përshihet me nenin 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, andaj bazuar në këto rrethana rezulton së mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankueses nuk ka konstatuar saktë përgjegjësinë disiplinore të ankueses, si dhe nuk ka cilësuar drejtë veprimet e ankueses si shkelje të lehtë disiplinore siç përcaktohet me nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë.

Siç u tha me sipër, Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.317/2022

Avdyll BEKTESHI

Bekteshi
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.